



Co-funded by  
the European Union

Co-funded by the Swedish  
International Development  
Cooperation Agency



Sweden  
Sverige



## THIRRJE PER EKSPERT/TRAJNER

Per ofrimin e njohurive përfaqësuesve të OJF vendore  
në fushën e integritit gjinor ne politikat vendore

në kuadër të projektit:

**“Integrimi gjinor në politikat socio-ekonomike  
të bashkive në qarkun e Lezhës”**

REAC-OR  
research in action



KVINNA  
KVINNA



PRAVA  
ZASVE

WOMEN'S RIGHTS CENTER  
CENTAR ZA ŽENSKA PRAVA



Co-funded by  
the European Union

Co-funded by the Swedish  
International Development  
Cooperation Agency



Sweden  
Sverige

## PËRMBAJTJA

1. INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME
  - 1.1 Autoriteti i kontraktuar
  - 1.2 Rreth organizatës
  - 1.3 Rreth projektit
  
2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET SPECIFIKE
  - 2.1 Objektivat dhe rezultatet e përgjithshme
  - 2.2 Zona gjeografike
  - 2.3 Puna specifike
  
3. MENAXHIMI I PROJEKTIT
  - 3.1 Organi përgjegjës
  - 3.2 Struktura e menaxhimit
  
4. LOGJISTIKA DHE KOHA
  - 4.1 Vendodhja
  - 4.2 Data e fillimit dhe periudha e zbatimit të detyrave
  
5. KERKESAT
  - 5.1 Kriteret specifike për Ekspertin/en – Trajnerin/en



Co-funded by  
the European Union

Co-funded by the Swedish  
International Development  
Cooperation Agency



Sweden  
Sverige

## 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

### 1.1 Autoriteti Kontraktues

Shoqata “Together for Life” Rr. Brigada e VIII-të, Pallati Jeshil, Shk.2, Al. 14, Tirana, Albania.

### 1.2 Rreth Shoqatës ‘Together for Life

Shoqata “Together for Life” është një organizatë jofitimprurëse, e themeluar më 24 dhjetor 2009. Misioni i “Together for Life” është promovimi dhe mbroja e të drejtat e njerëzve në nevojë, të mbështesë familjet dhe komunitetet e marginalizuara me qëllim integrimin e tyre në jetën sociale. Programet e “Together for Life” fokusohen në fushën e shëndetësisë, barazisë gjinore, çështjet mjedisore, turizmit, transparencës dhe llogaridhënies. “Together for Life” kryen një sërë aktiviteteve që lidhen kryesisht me informimin dhe edukimin, fushatat publike sensibilizuese, investigime, kërkime dhe shkrimin e raporteve studimore.

### 1.3. Rreth projektit të Shoqatës “Together for Life”

Projekti “Gender mainstreaming in the socio-economic policies of the municipalities in the region of Lezha” që do të implementohet nga Shoqata “Together for Life” në qarkun e Lezhës synon bashkëpunimin mes strukturave të qeverisjes vendore, organizatave lokale të shoqërisë civile, medias dhe sipërmarrjes me qëllim rritjen e kapaciteteve të tyre për analiza gjinore, monitorimin e angazhimeve gjinore të institucioneve. Një sërë takimesh dhe trajnimesh janë planifikuar me përfaqësues të aktorëve të përfshirë në projekt për ‘i informuar dhe ndërgjegjësuar ata lidhur me të drejtat e grave dhe promovimin e barazisë gjinore përmes Procesit të Anëtarësimit në BE.



Co-funded by  
the European Union

Co-funded by the Swedish  
International Development  
Cooperation Agency



Sweden  
Sverige

Përgatitja dhe publikimi i 4 intervistave me përfaqësues të qarkut Lezhë dhe bashkisë Lezhë mbi politikat vendore për mbështetjen e grave sipërmarrëse, 10 artikuj dhe 6 infografike do të përgatiten dhe do të publikohen në kuadër të projektit.

## 2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET

### 2.1 Objektivat dhe rezultatet e përgjithshme

Objektivat e projektit janë si më poshtë:

1. Zgjerimi i bashkëpunimit të pushtetit vendor me OJF-të vendore dhe grupet e interesit në qarkun e Lezhës për të forcuar demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e hartimit të politikave të ndjeshme gjinore në përputhje me politikat e BE-së.
2. Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve të OSHC-ve në qarkun e Lezhës për t'u angazhuar në mënyrë më efektive me bashkitë Lezhë, Miredita, Kurbin për hartimin, monitorimin, analizën gjinore, integrimin gjinor të politikave vendore në përputhje me politikat e BE-së.
3. Rritja e njohurive dhe ndërgjegjësimit të stafit të tre bashkive të qarkut Lezhë për dimensionet gjinore të procesit të anëtarësimit në BE, mbi rëndësinë e hartimit dhe zbatimit të politikave të fokusuara në arritjen e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave.

Rezultatet e pritshme:

1. Rrjetëzimi i OJQ-ve lokale dhe pjesëmarrja e përmirësuar e saj në vendimmarrjen lokale për integrimin e çështjeve gjinore në politikat lokale (rajonale dhe komunale);
2. Qarku dhe bashkitë janë përgjegjëse për integrimin e çështjeve gjinore në politikat lokale dhe rajonale dhe dokumentet e zhvillimit të hartuara dhe zbatuara prej tyre;



Co-funded by  
the European Union

Co-funded by the Swedish  
International Development  
Cooperation Agency



Sweden  
Sverige

## 2.2 Detyrat specifike

Eksperti/ja – trajneri/ja do të jetë përgjegjës për:

- Përgatitjen e modulit të trajnimit në të cilin do të përfshihen informacionet me të fundit rreth rrugëve/ mjeteve për integrimin gjinor në politikat vendore dhe rëndësinë e këtij procesi;
- Bashkëpunimin me stafin e projektit pranë TFL për përgatitjen e agjendës së trajnimit dhe trajnimin;
- Trajnimin e përfaqësuesve të shoqërisë civile me qëllim rritjen e njohurive të tyre rreth procesit të integrimin gjinor në politikat vendore dhe rritjen e aftësive në monitorimin e përfshirjes së gjinisë në politikave vendore;
- Të përdori të gjitha mjetet e nevojshme të pranuar në edukimin e të rriturve;
- Të respektojë pjesëmarrësit në trajnim dhe të ofrojë ambient të shëndetshëm trajnimi.

## 2.3 Angazhimi në projekt

Pershkrimi i detyrave	Vendi	Date/Estimated	Numri i ditëve të punës
Përgatitja e materialit të trajnimit	Zyre / tryezë	Qershor 2022	2 dite
Tranimi me përfaqësues të organizatave vendore të shoqërisë civile	Office	Qershor 2022	1 dite
Total Numri i përgjithshëm i ditëve të punës			3 dite

## 3. MENAXHIMI I PROJEKTIT

### 3.1. Organi përgjegjës

Shoqata “Together for Life” Rr. Brigada e VIII-të, Pll. Jeshil, Shk.2, Al. 14, Tirana, Albania

### 3.2. Struktura përgjegjëse





Co-funded by  
the European Union

Co-funded by the Swedish  
International Development  
Cooperation Agency



Sweden  
Sverige

Projekti zbatohet nga Shoqata

“Together for Life”.

Kjo shoqatë është përgjegjëse për prokurimin dhe implementimin e çdo aktiviteti.

### 3.3. Lehtësirat nga Autoriteti Kontraktues

Autoriteti kontraktor do të sigurojë për të kontraktuarin çdo informacion, dokumentacion dhe mbështetje që mund të jetë i rëndësishëm për zbatimin e kontratës.

## 4. LOGJISTIKA DHE KOHA

### 4.1. Vendodhja

Qarku Tiranë dhe/ ose Qarku Lezhë.

### 4.2 Data e fillimit dhe periudha e zbatimit të detyrave

Trajneri/ja fillon angazhimin në kuadër të projektit në datën 1 qershor 2022 dhe kontrata zgjat 1 muaj, deri në datën 30 qershor 2022.

## 5. KËRKESAT

### 5.1 Kërkesat specifike për Trainerin/en

Personat e interesuar për pozicionin e shpallur të trenerit/es sipas kësaj Thirrjeje duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

1. Të ketë kryer arsimin e lartë në degët shkencë juridike, shkencë sociale, ose fusha të ngjashme me to;
2. Të ketë eksperiencë të mëparshme të konfirmuar në ofrimin e trajnimeve të ngjashme me të rritur;



Co-funded by  
the European Union

Co-funded by the Swedish  
International Development  
Cooperation Agency



Sweden  
Sverige

3. Të ketë njohuri shumë të mira rreth hartimit dhe zbatimit të politikave qendrore dhe vendore me fokus gender;
4. Të ketë aftësi për të përcjellë mesazhin, për të dëgjuar dhe për ta orientuar bashkëbisedimin me pjesëmarrësit rreth temave kryesore të trajnimit
5. Të raportojë pranë projektit në mënyrë formale dhe joformale rreth ecuresë së trajnimit dhe pikave kryesore të tij, përfshirë pikat e forta dhe të dobta.

Kandidati duhet të paraqesë nëpërmjet emailit ose në zyrat e TFL (në adresat e mëposhtme):

- CV personale;
- Leter motivimi;
- Oferte financiare

Shoqata "Together for Life", Rr. Brigada e VIII-të, Pll. Jeshil, Shk.2, Al. 14, Tirana, Albania

Posta elektronike: [info@togetherforlife.org.al](mailto:info@togetherforlife.org.al)

Afati përfundimtar për aplikim është data 23 maj 2022, ora 17:00.

Aplikanti fitues do të njoftohet deri në datën 30 maj 2022 me email ose telefon në kontaktet e dhëna nga ai/ajo.